



Npi – 01/275 Datë: 24.11.2020

Duke u bazuar në nenin 17 pika (a) dhe (c), dhe nenin 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; Nenin 4 dhe nenin 8 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092; Nenin 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020. Kuvendi Komunal Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2020 mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN KOMUNALE ZONA KADASTRALE - DAVIDOVÇ

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 24.11.2020, me shumicën e votave APROVOI Vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, si vijon:

1. Ngastra Kadastrale me numër: P-72809023-00333-3, me sipërfaqe prej: 8000m², Kultura - Kullosë e klasit të -I- (parë). Z.K-Davidovc. Evidentuar "Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal" – Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 99 vite.
2. Pjesë nga Ngastra Kadastrale me numër: P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej: 21986m², Kultura - Kullosë e klasit të -I- (parë). Z.K-Davidovc. Evidentuar "Pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal" – Shtime. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim është 99 vite.

II

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronave të paluajtshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e planeve komunale si: Realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Përkrahjen e bizneseve vendore. Do të ndikojë pozitivisht në: Punësim, Investime, Shtimin e numrit të bizneseve, Rritje e numrit të taksapaguesve, Zhvillim ekonomik, dhe të hyra për Komunën.

III

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes konkurrencës së hapur publike (konkursit).

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

Faqe 1 nga 1